

Vetë-obligimi për qëndrueshmëri në vendpunishte

Si kompani zejtare me vetëdije për përgjegjësi jemi të përkushtuar për qëndrueshmëri në kompani dhe në vendpunishte. Jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që mbajmë lidhur me mjedisin, punëtorët tanë dhe shoqërinë. Për këtë qëllim ne obligohemi që projektet tona t'i realizojmë duke i pasur parasysh aspektet ekologjike, ekonomike dhe sociale.

Në frymën e qëndrueshmërisë gjithëpërfshirëse, obligohemi t'u përmbahemi masave të mëposhtme:

- 1. Eficienca energjetike dhe reduktimi i emetimeve:**
Ne zvogëlojmë konsumin e energjisë duke përdorur makineri dhe teknologji me eficiencë energjetike dhe, kurdo që është e mundur, edhe energji të ripërtërishme.
- 2. Menaxhimi i mbeturinave dhe riciklimi:**
Ne minimizojmë mbeturinat përmes menaxhimit eficient të materialeve dhe përkrahim ekonominë qarkore duke ndarë dhe ricikluar mbetjet e materialeve. Ne i japim përparësi përdorimit të materialeve ndërtimore me përbërje të ricikluar ose nga burime të qëndrueshme.
- 3. Ruajtja e burimeve dhe përzgjedhja e materialit:**
Ne përzgjedhim materiale regjionale dhe të qëndrueshme për të zvogëluar rrugët e transportit dhe minimizuar gjurmët ekologjike. Gjithashtu jemi përcaktuar për materiale miqësore me mjedisin dhe me ndotje të ulët. Jemi përcaktuar për ndërtim të bazuar në arsyeshmëri e cila jo vetëm ruan burimet por është edhe e mirë-menduar dhe ofron zgjidhje afatgjate. Klientëve tanë u ofrojmë alternativa të qëndrueshme të produkteve.
- 4. Menaxhimi i ujërave:**
Kemi bërë optimizimin e konsumit të ujit. Ne sigurojmë trajtim miqësor ndaj mjedisit të materialeve të rrezikshme për të shmangur ndotjen e ujit.
- 5. Mbrojtja nga zhurmat dhe cilësia e ajrit:**
Ne zvogëlojmë zhurmat dhe emetimet në ajër duke përdorur makineri moderne me emetime të ulëta dhe sigurojmë arsyeshmërinë e tyre mjedisore përmes mirëmbajtjes së rregullt të tyre.
- 6. Mbrojtja e punëtorëve dhe mbrojtja në punë:**
Ne sigurojmë kushte të sigurta dhe të shëndetshme pune duke iu përmbajtur vazhdimisht masave të sigurisë në punë dhe mbështesim trajnimet e mëtejme të punëtorëve tanë në lidhje me qëndrueshmërinë. Ne mbështesim kulturën fer të punës.
- 7. Optimizimi i trafikut dhe logjistikës:**
Duke realizuar liferime të grumbulluara dhe përdorim të mjeteve transportuese me emetime të ulëta, ne e zvogëlojmë vëllimin e trafikut. Ne mbështesim vozitjet në grupe njerëzish dhe elektromobilitetin për të redukuar trafikun vajtje-ardhje.
- 8. Përfshirja e komunitetit lokal:**
Ne mbështesim dialogun e hapur me banorët përreth dhe kemi konsideratë për interesat lokale, sidomos në lidhje me zhurmën, trafikun dhe ndikimet në mjedis, duke ndikuar kështu në pranueshmërinë e projekteve tona.
- 9. Planifikimi i qëndrueshëm i vendpunishteve:**
Që në fazën e planifikimit ne integrojmë aspektet e qëndrueshmërisë për të realizuar realizim të ndërtimeve të bazuar në ruajtjen e burimeve dhe në eficiencë. Ne verifikojmë rregullisht proceset tona dhe i përshtasim ato për të arritur objektivat tona të qëndrueshmërisë.
- 10. Përkrahja e inovacionit:**
Ne jemi të përkushtuar në përmirësim të vazhdueshëm të proceseve tona duke testuar dhe integruar teknologji dhe metoda të reja, të qëndrueshme ekonomikisht dhe ekologjikisht. Në këtë mënyrë, ne jemi gjithmonë të përditësuar dhe rrisim vazhdimisht eficiencën mjedisore dhe burimore.



Me këtë vetë-obligim ne i përmbahemi procesit të qëndrueshëm të ndërtimit, i cili jo vetëm që i plotëson kërkesat e së tashmes, por i merr parasysh edhe brezat e ardhshëm. Ne e konsiderojmë si përgjegjësi zbatimin e praktikave më të mira të qëndrueshmërisë në secilën nga vendpunishtet tona.